



Nr. 77 Prot

Tiranë më 15.01.2016

Lënda: Dërgim Informacioni

Z. Gjergj EREBARA
Balkan Investigative Reporting Network Albania

TIRANE

I nderuar Z.EREBARA

Në vijim të shkresës Suaj të datës 28.12.2015 të dërguar në ERE, në lidhje me kërkesën për dhënie informacioni, Ju bëjmë me dije se :

1-) Aplikimet e plota të OSHEE sh.a; KESH sh.a., OST sh.a. për ndryshime të çmimeve për vitin 2015, janë të publikuara në faqen zyrtare të web të ERE www.ere.gov.al nën zërin “Publikime”- “Aplikime”. Këto të dhëna gjenden në faqen zyrtare të internetit që nga viti 2011 e në vijim.

2-) Në lidhje me tarifat e vitit 2016, vendimmarrja për të cilat është sanksionuar me vendimin e Bordit të ERE nr 156 të datës 24.12.2015, nuk ka patur aplikime për tarifa të reja, por kërkesa nga të tre subjektet e licencuara OSHEE sh.a; KESH sh.a., OST sh.a. për ngrirjen e tarifave ekzistuese deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2016. Gjithashtu, MEI me shkresën nr 7094/5 prot, datë 02.12.2015 shprehu qëndrimin, duke vlerësuar se shtrirja e efekteve të tarifave dhe çmimeve aktuale deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2016, si dhe shtyrja e procesit të aplikimeve të kompanive për këtë periudhë, do shërbente në kryerjen e një analize më të saktë të vlerësimit të të ardhurave të kërkuara të kompanive. Në zbatim të nenit 10/3 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për energjinë për sa u takon çështjeve objekt i këtij ligji. Bashkëlidhur do të gjeni kopje të këtyre korrespondencave zyrtare.

1

3-) Sa i përket pikës së tretë të kërkesës suaj, Ju sqarojmë se, ERE asnjëherë nuk ka ndërprerë publikimin në faqen zyrtare të web të aplikimeve të plota për tarifatat vit pas viti. Ato i gjeni nën zërin “Publikime”-“Aplikime”. Gjithashtu Ju bëjmë me dije se vendimet e Bordit të ERE botohen në kohë reale, konsideruar si të tillë harkun e domosdoshëm të kohës që nevojitet për zbardhjen dhe nënshkrimin e tyre, që në më të shumtën e rasteve nuk kalon 24 orë. Ndërkohë çdo herë që Bordi i ERE mbledhet e shprehet me vendim, gjeni të publikuar në faqen e ERE, brenda pak orëve *sinopsis* të vendimmarrjes së Bordit të ERE.

Me respekt,

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

Nr. 7694 Prot.
5

Tiranë, më 02.11.2015

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar i Bordit të Komisionerëve të ERE

TIRANË

Lënda: *Kthim përgjigje*

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës Suaj nr. 638, datë, datë 28.10.2015, përsa i përket përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, në të cilat ngrini shqetësimet tuaja mbi këtë proces, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë shprehim qëndrimin tonë si më poshtë:

Siç jeni në dijeni, gjatë këtyre dy viteve të fundit, Qeveria u përball me një situatë shumë të vështirë financiare në sektorin e energjisë elektrike, mbasi trashëgoi një sektor pothuaj ne prag të falimentimit me një situatë financiare pa likuiditete.

Pas zgjidhjes së konfliktit me CEZ, Qeveria u përball me sfida për stabilizimin e sektorit dhe kthimin e ligjshmërisë së pagesave duke i hapur rrugë kështu investimeve në këtë sektor. Ne sagë të kësaj mbështetjeje, gjate vitit 2015, rezultatet janë të reduktimit të humbjeve në shumë se 7% dhe rritjen e arkëtimit me 10%, janë vërtetë inkurajuese.

Paralelisht, Qeveria ndëmoi një reforme legjislativë me hartimin e një kuadri të ri ligjor, e cila filloi me miratimin e ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe ligjin për sektorin e gazit natyror, në harmoni me paketën e trete legjislativë.

Gjithashtu sapo është miratuar në Kuvend ligji për eficienten e energjisë elektrike, ndërkohë që ka përfunduar hartimi i Planit Kombëtar të Energjisë të Rinovueshme i cili është në fazë miratimi. Në të njëjtën kohë po punohet gjithashtu për ndryshimet e nevojshme në ligjin e burimeve të rinovueshme të energjisë, për të përmbyllur kështu reformën legjislativë në këtë sektor.

Ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike nr.43/2015, ka tritur në një shkallë me të lartë pavarësinë dhe forcimin e Rregullatorit dhe garanton hapjen e tregut, duke plotësuar kështu një nga kërkesat me kryesore të Direktivës 9072/2012. Ministria e Energjisë në këtë kuadër,

me ndihmën e Sekretariatit dhe të partnereve si USAID, Qeveria e Norvegjisë, Bashkimin Europian, po punon për hartimin e akteve nënligjore, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.

Reforma tarifore e ndërmarrë vitin e kaluar, bazuar në rezultatet e mësipërme, ka rezultuar efektive dhe e drejte. Në këtë aspekt, kjo reforme krijoi kushtet për hapjen e tregut mbi bazën e një organizimi të ri për ngritjen e strukturës së tregut, tarifave të aksesit në rrjet, etj.

Me ndihmën e konsulentëve të *Nord Pool*, ka nisur të zhvillohet ideja e krijimit për Bursën e Shqipërisë, *Albanian Power Exchange*, duke mbështetur idenë se në vendet e rajonit tone, me një treg të vogël individual, është i domosdoshëm organizimi i një tregu rajonal, për të rritur eficienten e gjenerimit në drejtim të reduktimit të kostove në interes të konsumatorëve.

Në këto kushte, objektivi i Qeverisë Shqiptare, është zhvillimi i një tregu të energjisë elektrike që të sigurojë furnizim të qëndrueshëm, të sigurtë dhe të përshatshëm me energji elektrike me çmime të përballueshme në një mënyrë të shëndetshme ekonomike dhe mjedisore dhe në përputhje me parimet e pranura komerciale, të tregut dhe legjislativin në fuqi.

Për të përmbushur këtë qëllim, është e rëndësishme arritja e objektivave për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike, duke e kthyer këtë sektor financiarisht dhe teknikisht të qëndrueshëm.

Në këtë kuptim, Ministria e Energjisë dhe Industrisë vlerëson si sfida, çështjet që lidhen me sa më poshtë:

- Në mënyrë të veçantë me hartimin e Modelit të Tregut të Energjisë, ku përfshihet një periudhë tranzitore për të transferuar aktivitetin e FPSH të Furnizuesi Publik me Pakice, pjesë e OSHEE sh.a.
- Mbylljen e detyrimeve të ndërsjella, e cila është një problematikë e mbartur që nga viti 2012, për të cilën referuar VKM nr. 126, datë 11.02.2015 ka filluar procesi i shuarjes me kompensim të detyrimeve të ndërsjella të shoqërive të sektorit energjetik dhe sikurse behet me dije edhe nga ana juaj, shuarja me kompensim e detyrimeve reciproke është një proces kompleks që kërkon kohë për evidentimin, rakordimin, shlyerjen dhe kompensimin e tyre.
- Nga ana tjetër, problematike mbetet vlerësimi i të ardhurave të kërkuara të Furnizuesit Publik i cili ka detyrimin e blerjes së energjisë nga PVE-te, (detyrim ky që zë një pjesë të konsiderueshme në kostot e blerjes së energjisë elektrike për konsumatorët tarifore), si pasojë e mos përcaktimit të formulës së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga këta prodhues.

Në këto kushte, në këtë periudhë tranzitore të hartimit të akteve ligjore dhe rregullatore përkatëse, kryerja e një analize dhe vlerësimi për të ardhurave të kërkuara nga ana e secilës prej kompanive publike, KESH, OST dhe OSHEE, është lidhur me llogaritjen e kostove të

operimit për të përmbushur aktivitetin në përputhje me kriteret që përcakton ligji si dhe bën të pamundur përlitësimin e tarifës për periudhat e mëparshme rregullatore si pasojë e situatës së financiare të trashëguar, e cila është reflektuar tek marrëdhëniet e ndërsjella midis tre operatoreve. Gjithashtu vazhdimi i proceseve të nisura për rakordimin e detyrimeve midis palëve dhe si dhe vazhdimi i aksionit të iniciuar nga Qeveria për përmbushjen e objektivave për rritjen e performancës së kompanisë, në përputhje me Planin e Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë, e cila do të përcaktojë targetet e kompanive publike për periudhën e ardhshme rregullatore.

Kuptojmë se ligjëvënësi për qëllime të implementimit të këtij ligji, në dispozita të veçanta (neni 109, pika 5 dhe 110 pika 2) ka përcaktuar se:

"Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji"

"Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj".

Gjithashtu nga ana e shoqërive KESH, OST dhe OSHEE, është raportuar së fundmi në MEI (bashkëlidhur shkresat), se të ardhurat e realizuara mbi bazën e tarifave aktuale të miratuara nga ERE për vitin 2015, mundësojnë vijimin e aktivitetit në kushte normale për 6-mujorin e parë të vitit 2016.

Duke patur në konsideratë sa më sipër, në funksion të ushtrimit të detyrave si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit të energjisë elektrike, vlerësojmë se shtrirja e efekteve të tarifave dhe çmimeve aktuale deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2016, si dhe shtrirja e procesit të aplikimeve të kompanive për këtë periudhë, do shërbenë në kryerjen e një analize më të saktë të vlerësimit të ardhurave të kërkuara të kompanive, në përputhje me objektivat e cituara më sipër.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI





KORPORATA ELEKTROENERGETIKE SHQIPTARE
DPMS/DMK/SCRR Nr. 7094/1 Prot
Tiranë, më 21.11.2015

Drejtuar: Z. Damian GJIKNURI, Ministër i Energjisë dhe Industrisë

Për dijen: Z. Petrit AHMETI, Kryetar i Bordit të ERE

Lënda: Përgjigje shkresës suaj Nr.7094/1, datë 10.11.2015, me objekt "Mbi përcaktimin e tarifave nga ana e ERE";

I nderuar Z. Ministër,

Shoqëria KESH sh.a në përgjigje të shkresës suaj Nr. 7094/1, datë 10.11.2015, me objekt "Mbi përcaktimin e tarifave nga ana e ERE" ku na kërkohet të informojmë mbi gjendjen e të ardhurave të realizuara mbi bazën e tarifave të miratuara nga ERE për vitin 2015 si edhe mundësinë e ushtrimit të aktivitetit në kushte normale për 6-mujorin e parë të vitit 2016 mbi të njëjtën bazë tarifore, informon se:

- Të ardhurat e realizuara nga shoqëria KESH sh.a (për periudhën Janar – Tetor 2015) në funksionin e Prodhimit dhe atë të Furnizimit Publik me Shumicë në tregun e rregulluar, sipas tarifave të miratuara nga ERE, janë në vlerën e 11.2 mld lekë. Të ardhurat e shoqërisë KESH sh.a (KESH-GEN/FPSH) për vitin 2015 (të pritshme), në tregun e rregulluar, parashikohen të jenë në vlerën 13.6 mld lekë;
- Shpenzimet e shoqërisë KESH sh.a vetëm për blerjen e energjisë elektrike nga importi, PPE/PVE-të dhe HEC. Ashta (për periudhën Janar -- Tetor 2015) janë në vlerën 7.7 mld lekë, ndërsa shpenzimet për vitin 2015 (të pritshme) parashikohen të jenë në vlerën e 10.4 mld lekë.
- Të ardhurat shtese të krijuara nga shoqëria KESH sh.a në 6-mujorin e parë të vitit 2015 (eksport/optimizim energjetik në tregun e parregulluar) janë në vlerën e 5.3 mld lekë. Këto të ardhura shtese janë përdorur nga ana e shoqërisë KESH sh.a për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për energjinë elektrike të blerë nga PVE/PPE-të, importin e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji elektrike të klientëve tariforë për 3-mujorin e fundit të vitit 2015, si edhe gjithashtu janë përdorur për uljen e nivelit të OD (overdrafteve) që shoqëria ka në bankat e nivelit të dytë;
- Në tarifën e miratuara për vitin 2015, nuk pasqyrohet rritja e prodhimit të energjisë elektrike nga PPE/PVE që parashikohet të fillojë operimin në vitin 2016, pra efekti financiar i këtij ndikimi nuk reflektonet në tarifën aktuale të vitit 2015.


Referuar faktit që jemi në periudhën tranzitore të hartimit të akteve nënligjore dhe rregullatore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", KESH sh.a deri në miratimin e tyre do përbushë të gjitha detyrimet si pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike bazuar në aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi, për sa këto akte nuk bien në kundërshtim me ligjin. Në lidhje me mundësinë e shoqërisë KESH sh.a. për ushtrimin e aktivitetit të saj për 6-mujorin e parë të vitit 2016, mbi të njëjtën bazë tarifore të vitit 2015, gjykojmë se KESH sh.a si një shoqëri e miradministruar do të mund të ushtrojë aktivitetin e saj pa u përballur me vështirësi serioze në rast se:

- shoqëria OSHEE sh.a për vitin 2016 do të shlyejë 100% të vlerës së faturës korrente ndaj KESH sh.a;
- shoqëria OSHEE sh.a për vitin 2016 do të skedulojë shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH sh.a; si edhe
- duke përjashtuar çdo situatë tjetër të paparashikueshme;

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, me respekt,

ADMINISTRATORI

AGRON HETOJA



Bulevardi. Bajram Curri
Rruga Viktor Eftemiu,
Tiranë, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581
info@ostal
www.ostal

Nr. DE. E 331/Prot
1

Tiranë, më 25/11/2015

Drejtuar: **Z. Daniel Gjoknuri**
Ministër
Ministria e Energjisë
dhe Industrisë

Subjekti: Përgjigje tuajes nr. 7094/1 date 10.11.2015

I nderuar Z. Gjoknuri,

Në vijim të shkresës tuaj nr. 7094/1 prot date 10/11/2015 "Mbi përcaktimin e tarifave nga ana e ERE" me anë të së cilës kërkohet informacion mbi gjendjen e të ardhurave të realizuara mbi bazën e tarifave aktuale të miratuara nga ERE për vitin 2015 për OST sh.a., Ju bejme me dije se;

Keto të ardhura deri më 30.10.2015 arrijne shifren prej 3,590 milion leke dhe të ardhura të pritshme deri më 31.12.2015 parashikohet të jene 4,060 milion leke.

Përsa i takon 6-mujorit të parë të vitit 2016 të ardhurat e pritshme, llogaritur sipas tarifave aktuale të miratuara nga ERE, parashikohet të jene në vlerën 2,189 milion leke nga të cilat OST sh.a. pret të arketojë nga OSHEE 95% të fatures së transmetimit duke e çuar totalin e arketimeve në **2,091 milion leke**. Shpenzimet e parashikuara për funksionimin normal të aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike për këtë 6-mujorë pritet të jene në vlerën **1,165 milion leke** (pa përfshirë amortizimin).

Investimet e nevojshme për operimin e sigurtë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të programuara për vitin 2016 janë në shumën e 1,655 milion leke. Ndërsa për 6 mujorin e parë të vitit 2016 OST sh.a. parashikon të investojë rreth 45% të totalit në vlerën **745 milion leke**.

Në total për 6 - mujorin e parë të vitit 2016 OST sh.a. pritet të shpenzojë dhe investojë **1,910 milion leke**, duke lënë rreth **181 milion leke** fonde të lira që do përdoren për shlyerjen e detyrimeve të tjera të OST sh.a. Në këto detyrime të tjera, një pjesë shumë të rëndësishme kanë, detyrimet e OST sh.a. për të paguar **principlin dhe interesin** (për kredite në të cilat është angazhuar), gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2016, në total kapin vlerën **1,270 milion leke**. Pamjaftueshmëria e fondeve do të sjellë pamundësi të shlyerjes së detyrimeve korentë për kredi dhe principlin gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2016.

Detyrimet e papaguara të akumuluarat të OST sh.a ndaj të treta arrijne në vlerën 2,475 milion leke të analizuar si më poshtë:


- Detyrime per KESH sh.a. ne vleren 664 milion leke
- Detyrime per dividend per MZHETTS ne vleren 629 milion leke
- Detyrimet per huate e prapambetura ne vleren 735 milion leke
- Te tjera detyrime ne vleren 447 milion leke.

Besojme, se informacioni i mesiperme do te jete i njafueshem per Ministrine e Energjise dhe Industrise, ne cilesine e ministrise pergjegjese per politikat ne sektorin elektroenergjitik, per te vluar me qendrimin perkates ne lidhje me kete ceshtje.

Duke ju falenderuar per mirëkuptimin,

Administrator i OST sh.a

Engjëlli ZEQQ



2- PARASHIKIMI I AKTIVITETIT TE OSHEE PER VITIN 2015 DHE 6-MUJORIN E PARE TE 2016

Treguesit kryesore te performances se OSHEE te priteshem per vitin 2015 dhe 6 mujorin 2016 te krahasuar me vitin 2014 paraqiten ne tabelen si me poshte:

0001 Leke	Pershkrimi	2014	2015	2016 6-mujor
Te ardhurat	Nga aktiviteti kryesor (shirja e Energjise)	43,412,009	51,018,348	25,703,654
	Te tjera	3,840,267	3,167,713	686,646
	Gjithsej	47,252,276	54,186,061	26,390,300
Shpenzimet	Shpenzime Energji dhe Transmetim	34,198,681	31,106,068	15,396,442
	Shpenzime Operative	10,728,753	8,230,638	5,660,975
	Provizione	309,332	22,652	1,507,446
	EBITDA	2,015,511	14,826,703	3,825,436
	Amortizimi	2,946,673	1,874,810	1,294,214
	Shpenzime Financiare	1,144,290	1,751,749	794,344
	Tatim Fitim	2,435,034	2,260,443	260,532
	Gjithsej	51,762,761	45,246,360	24,742,953
	REZULTATI I AKTIVITETIT	(4,510,485)	8,939,701	1,476,346
	Te Ardhura te Jashtezakonshtme	-	3,869,477	-
REZULTATI I PERIUDHES	(4,510,485)	12,809,178	1,476,346	
INVESTIMET		698,483	3,860,690	6,252,162
ENERGJI (MWH)				
	Energji e Bfere	6,935	6,615	3,259
	Energji e Shtuar	4,313	4,511	2,365
	Humbje %	37.8%	31.8%	27.4%

Ne tabelen me sipër:

- Te ardhurat e vitit 2015 pritet te jene rreth 15 % me te larta se ato te vitit 2014. Ne vitin 2016 per shkak te uljes se te ardhurave te parashikuara nga kamatevonesat dhe daljes se klienteve te njetit 35Kv, pritet qe te ardhurat te jene vetem 0.3% me te larta..
- Rritja e planifikuar e shpenzimeve operative ne vitin 2016 lidhet kryesisht me shpenzime ne mirembajtjen e njetit elektrik i cili eshte akoma ne gjendje kritike. Gjithashtu planifikohet nje rritje e shpenzimeve per personelin kryesisht per stafin ne terren, duke bere te mundur realizimin e politikave dhe strategjise qe shoqeria ka per vitin 2016 e ne vazhdim.
- Investimet per vitin 2016 pritet te jene ne nivele njaft te kenaqshme duke qene se vitin qe vjen shoqeria do ti filloje investimet prej dates 1 Janar si dhe do te vazhdoje realizimin i investimeve te nisura prej vitit 2015.
- Rezultati financiar i shoqerise per vitin 2016 parashikohet te rezultoje pozitiv, i cili do te beje te mundur realizimin e planit te investimeve te shoqerise, i cili per vitin 2016 parashikohet te realizohet ne bashkëpunim dhe me fondet nga kredia e Bankes Boterore.